



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe Excel Investments Netherlands B.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni që synon krijimin e një ndërmarrje të përbashkët / joint-venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe Excel Investments Netherlands B.V.

Referuar “Marrëveshje ortakësh”, palët janë:

**Pala 1:** Saudi Aramco Development Co Ltd. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, e angazhuar në furnizimin dhe tregtimin e naftës, gazit, petrokimike, shërbimet komunale dhe furnizime industriale. Saudi Aramco Development Co Ltd. është një filial në pronësi të plotë të shoqërisë Saudi Arabian Oil Company.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri, por gjeneron të ardhura përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

**Pala 2:** Excel Investments Netherlands B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin e holandez, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve logjistike.

Excel Investments Netherlands B.V. është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Deutsche Post AG, shoqëria mëmë e Deutsche Post DHL Group.

Deutsche Post DHL Group është prezent në Shqipëri nëpërmjet filialit të tij DHL International (Albania) SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. DHL International (Albania) SHPK ka si objekt të aktivitetit të saj transportin me të gjitha mjetet: transport tokësor, detar, ujor dhe ajror dhe kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale, financiare, pasurore, e cila lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin tregtar të shoqërisë.

**Ndërmarrja e Përbashkët (JV)**, do të themelohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Aktiviteti i shoqërisë JV do të jetë: Të zhvillojë, operojë dhe mirëmbajë objektet për ofrimin e shërbimeve në zonën gjeografike të Arabisë Saudite dhe Rajon; të tregtojë, zhvillojë, shesë dhe ofrojë shërbime në zonën gjeografike; të kryejë aktivitete kërkimore dhe zhvillimore në lidhje me shërbimet

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin

10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet postës në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**